

TRIODI  
DHE  
PESEDHJETORJA



*E Përktheu*

IMZOT FAN STYLIAN NOLI

*E Botoj*

PESHKOPATA E AMERIKES

BOSTON, MASS.

1952

GJYSHES SE DASHUR  
SUMBA GJERQ NOLI  
PER KUJTIM TE PERJETME

PERKTHENJESI

PJESA E PARE  
TRIODI  
E DIELA E PUBLIKANTT EDHE FARISIANIT  
THIRRTORET

*Këndohen dhjetë, domethënë shtatë të Tingëllit edhe dy dy të Triodit, dyke përsëritur të parën:*

T. I. Le të mos falemi farisianisht o vëllezër, se ay që e lartëson veten do të përunjet, po le të përunjemi përpara Perëndisë si Publikani, dhe le të thërresim të agjëruar: Kij mëshirë për ne mëkatarët o Perëndi.

Farisiani i fryrë prej ambicjes së kottë, dhe Publikani i krusur prej pendimit, t' u-afuan o Zot i vetëm; po ay i humbi të mirat me mburrjen, dhe ky i trashëgoj dhuratat me heshtjen. Me këto psherëtime përkrah-më, o Krisht o Perëndi si njeridashës.

LAVDI, T. T. IV. O Zot i gjithëfuqishim, e di sa forcë kanë lotet: Se e çkëputnë Ezekinë nga vdekja, se e shpëtuan mëkatarin nga gremina, dhe e drejtësuan Publikanin përmi Farisianin. Të lutem pra nëmëro-më me ata dhe mëshiro-më.

*Tania e Tingëllit, edhe Pasvargjet e Tingëllit.*

LAVDI, T. T. I. Sytë më janë rënduar nga mëkatat, edhe nukë munt t'i ngre përpjetë, dhe ta shikonj kulmin e qiellit, po prit-më të penduar si Publikanin dhe mëshiro-më o Shpëtimtar.

*Tania e Tingëllit, edhe Përlëshoret e Tingëllit.*

## SHKURTORJA, T. III

## PAS I PARTHENOS SIMERON

Le t'i sjellim psherëtim, si Publikani Perëndisë, dhe përdhe mëgjunjazi, si mëkatarë le t'i biem, se ay, pruri shpëtimin, për njerëzinë, dhe i ndjen, të gjith' ata që po pendohen, se për ne u-mishërua, i Bir' i Atit, që nukë ka nisje.

## SHTEPIA

Le të përunjemi të gjithë o vëllezër, dhe le ta goditim ndërgjegjen me psherëtime dhe vajtime, që të çfaqemi besnikë, të pafajmë dhe të falur, përpara gjyqit të përjetmë; se atje me të vërtetë është ndjesa, të cilën lutemi tani ta shohim; se atje në Parajsën e çudiçime nukë ka as dhëmbje as helme as psherëtim; se atë e ka krijuar Krishti Perëndi, i Bir' i Atit, që nukë ka nisje.

## SINAKSARI

Gjithë sot, kujtojmë parabollën e Publikanit edhe Farisianit prej Ungjillit të Shën Llukajt.

Me nërmjetimet e Gjithë Shenjtorëve çudibërës, o Krisht o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

## ZBRITESORET, T.T.II

## OS EN IPIRO PEZEFSAS O ISRAIL

*Këndohen një javë pas Përhasjes.*

I. E kapërceu më këmbë Detin e Kuq, Israeli me lavdi, dhe të mbytur e shikoj, ushtërinë ndjekëse, dhe Zotin hymnonte besërisht, me këngë mundëse.

III. Si ti të shenjtë s' ka, o Zot Perëndia ynë, dhe përperjetë e ngrite, ballën e besnikëve, edhe na dhe shiguri mi shkëmbin e rëfimit tënt.

IV. O Krisht o Perëndi, ti forca ime je, Kish' e shenjtë thërret e të këndon, këngë brohoritëse, me tërë zemrën besërisht, në shërbesat e të kremteve.

V. Në dritën tënde o Zoti Krisht, ndrit-i zemrat e besnikëve me mall dhe dashuri, bëj-i që të besojnë, që i Bir' i Perëndisë je, dhe shpëtoj-i nga gremina e mëkatave.

VI. Kur detin e jetëve të përzier e shikonj, prej ngasjeve dhe shqotave, menjëherë në limanin tënt, sulem dyke thirrur. Prej prishjes ti më shpëto, Zot i dhëmpshur i mëshirave.

VII. Furra çfaqet vesëprurëse, me krahun e Engjëllit, për Tre Djemat në zjarr, me një urdhër të perëndishmë, populli thërret, dhe Mbret' i Kaldenjve tok me ta: O Perëndi dhe Zot i Math, për jetë i bekuar je.

VIII. Për Tre Djemat e bëre, flagën vesonjëse, për flin' e të drejtit, ujën e bëre zjarr, se çdo gjë o Krisht, posa e do e bën. Pra të lavdërojmë përherë dhe për jetë.

IX. Asnjë njeri Perëndinë nuk e sheh, se nuk e shohin dot as ushtërit' e Engjëjve. Po me ty o Hyjlin-dëse, u-duk përmi dhe Fjala e mishëruar; pra kur mblidhemi, madhështojmë ty dhe Zotin Krisht, tok me gjith' Engjëjtë.

*Pas Dërgimësore Ngjallësore këndohen:*

## DERGIMESORET, T. II.

## PAS TIS MATHITES SINELTHOMEN

Besnikë neveriteni, mburrjen farisiane, si Publikani me pendim, çfaqni përunjësinë, dhe lartësojeni

shpirtin, edhe thirrini Zotit: Mëshirë kij o Zoti Krisht, o i Bir i Marisë o Shpëtimtar, që për ne durove Kryq edhe vdekje, edhe i ngjalle njerëzit, me fuqi perëndore.

O Krijetar i botëve, o Zot i gjithësisë, prej Shën Marisë more trup, dhe njeri pa ndryshuar, për njerëzit na u-bëre, na e përsërite shpirtin, të prishur prej mekatave, ti që linde prej Nënë çuditërisht, pra thërresim besërisht të gjithë, me lavdërim dhe brohori. Zonj' e jetës gezohu.

#### LAVDERIMET

*Këndohen pesë të Tingëllit edhe dy të Triodit, dyke përsëritur të parën:*

T. III. Shiko o shpiti im ndryshimin, midis Publikanit edhe Farisianit, urrej-e mburrjen e keti, imitoj-e përunjësin' e ati dhe thirr: Fal-më o Perëndi, dhe kij mëshirë për mua mëkatarin.

Urrejjeni o besnikë, mburrjen e Farisianit, edhe kini zili për pendimin e Publikanit, mos e lartësoni veten, po përunjuni dhe thërrisni besërisht: O Perëndi na i ndje mëkatat.

LAVDI, T. II. Farisianin që mburrej me veprat, edhe e drejtësonte veten, e dënove o Zot, edhe Publikantin e përunjur, që lypte ndjesë me psherëtim e drejtësove, se nuk i pëlqen mejtimet kryelarta, dhe zëmrat e thyera nuk i meprizon; përandaj pra të biem nër këmbë me përunjësi, ty që ke pësuar për ne dhe të thërresim: Fal-na ndjesën dhe përdëllimin e math.

TANI. E përmibekuar je, o Hyjlindëse Virgjër-eshë . . . .

*Doksologjia e Madhe. Në Hyrjen këndohen Tropari i Tingëllit, i Shenjtit të Kishës, pastaj:*

#### SHKURTORJA, T. IV

#### PAS EPEFANIS SIMERON

Nga Farisiani lark, le të qëndrojmë, dhe le t'i përunjemi, si Publikani me vajtim, le të thërresim me zë të math: Zot kij mëshirë, për ne që pendohemi.

#### APOSTULLI

Faluni dhe çpagojeni Zotin Perëndinë tonë.

Zoti është i njohur në Jude.

Këndimi prej Letrës II së Palit për Timotheën.

Bir Timothe, më ke pasuar në mësimin, në rritjen, në qëllimin, në besën, në zëmërgjerësinë, në dashurinë, në durimin, në ndjekjet, edhe në vojtjet, që na kanë ngjarë në Antioki, në Konjë, dhe në Lysrë. Sa ndjekje kam vojtur, po nga të gjitha më ka shpëtuar Zoti. Dhe ashtu do të ndiqen të gjithë ata, që duan të rrojnë pietozisht më Krishtin Jesu. Po njerëzit e liq dhe gënjeshtarë do të përparojnë për më keq, dyke rejtur dhe dyke u-rejtur. Po ti qëndro në ato, që ke mësuar dhe që ke besuar, se e di nga cili i mësove, dhe i di që prej foshnjërie Shkripturat e Shenjta, të cilat mundin të të urtësojnë për shpëtimin me anën e besës më Krishtin Jesu, Zotin tonë.

#### UNGJILLI PAS LLUKAIT

Zoti tha këtë parabolë: Dy njerës u-ngjitnë në Shenjtëroren të falëshin. Njëri ishte Farisian dhe tjetri Publikan. Farisiani qëndroj, edhe falej me vete kështu: "O Perëndi, të përhironj që nukë jam rëmbenjes, i padrejtë, dhe kurvar, si njerëzit e tjerë a si ky Publikan. Agjëronj dy herë në javë, dhe jap të dhjettën e tërë pasurisë që kam." Dhe Publikani qëndroj për

së largu, dhe nukë deshte të ngrente as sytë në qjell, po e goditte krahërorin, edhe thoshte: “O Perëndi, kij mëshirë për mua mëkatarin.” Ja ku ju thom se ky zbriti në shtëpinë e vetë më i drejtësuar se ay. Se cilido, që e lartëson veten, do të përunjët, po ay, që e përunj veten, do të lartësohet.

*Pastaj vazhdon Mesha e Shën Joan Gojartit.*